

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Veprimtari Idriz Rrecaj është ndër të identifikuarit në varrezat masive në Zubin Potok
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/veprimtari-idriz-rrecaj-eshte-nder-te-identifikuarit-ne-varrezat-masi-i515151
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 15:33:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	137ca497d0dcf6672b4701931d29eb648baaa39dedccb4043cbaffc126b333a4
TEKSTI	7b4b51d0d3f9570ede89a2348ae7ad80e17451aa36c963f1adfcc3f0d642e41e
PAMJA	974f5534853345fd8ebc8578c2bcdde1f2e0576603ea4e1a2a8eff193902ca95

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2eed4ee339b4cb4a0efdac2251ce0c587405553c3f357e125827143dfbb0e973
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	27cd3d5362ad8606db4b4a4bb83953e8ab924c30f9fa24532364779df926f41e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2eed4ee339b4cb4a0efdac2251ce0c587405553c3f357e125827143dfbb0e973>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

6 ORE ME PARE

KËRCET ARMA NË SARANDË/
Ekzekutohet Artan Myrtaj nga 2 persona me
motor, plagoset dhe një kalimtar

21 ORE ME PARE

112 ditë protesta kundër qeverisë/ Qytetarët
mbledhen sërish në Bulevard, kërkojnë
ndryshimin e Kodit Zgjedhor

1 DITE ME PARE

"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama
është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka
për ripërtëritjen e saj

1 DITE ME PARE

Krim brenda familjes në Tiranë/ I
moshuari godet me thikë gruan, 58-vjeçarja
ndërron jetë në spital. Autori kapet pas disa
orësh arrati (EMRAT+ VIDEO)

Aktualitet

Veprimtari Idriz Rrecaj është ndër të identifikuarit në varrezat masive në Zubin Potok

Idriz Rrecaj, i dekoruar më 2019 si "Hero i Kosovës", ishte veprimtar politik, i cili së bashku me 22 persona të tjerë shqiptarë, të njohur si "grupi i intelektualëve", u zhduk në kohën kur lufta e forcave serbe në Kosovë ishte intensifikuar.



20 Shtator 2026, 17:20
Nga E.d



Idriz Rrecaj

Veprimtar politik nga Skenderaj, Idriz Rrecaj, është ndër tre personat e identifikuar pas analizave të ADN-së disa javë pas zhvarrimit të mbetjeve mortore të zbuluara në varreza masive në lokacione të ndryshme në veri të Kosovës, njoftoi familja e tij të dielën.

Idriz Rrecaj, i dekoruar më 2019 si "Hero i Kosovës", ishte veprimtar politik, i cili së bashku me 22 persona të tjerë shqiptarë, të njohur si "grupi i intelektualëve", u zhduk në kohën kur lufta e forcave serbe në Kosovë ishte intensifikuar.

"Pas 27 vjetësh pritje, dhimbje dhe pasigurie, morëm lajmin nga institucionet tona që nga laboratorit i ADN-së në Hagë është konfirmuar zyrtarisht identifikimi i prindit tim, Idriz Rrecaj", shkroi në Facebook i biri i tij, Shpëtim Rreci.

"Pyetjes 'Ku është Idriz Rrecaj?' i erdhi fundi. Më në fund kemi përgjigjen që e kemi pritur për kaq gjatë. Gjaku nuk humb kurrë", shtoi ai.

Njoftimi i Rrecit vjen një ditë pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bëri të ditur se ishin identifikuar tri viktimat e para të varrezave masive të zbuluara në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut gati dy muaj më parë.

Sipas Kurtit, raportet e ADN-së kishin konfirmuar se tri viktimat i përkasin grupit të njohur si "grupi i intelektualëve", kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Kryeministri nuk kishte treguar me emër dhe mbiemër se kush ishin viktimat.

editoriale

Andrey Kortunov

Zgjedhjet në Rusi janë më shumë sesa teatër politik

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Në vëmendje

POLITIKE 20 SHTATOR 2026, 16:00

Nga "George Washingtoni i Kosovës" te Haga/ Hashim Thaçi, njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

POLITIKE 20 SHTATOR 2026, 15:54

Gjoha 110 mln euro e Arbitrazhit! Shqipëria u rrezua edhe nga Gjykata e Apelit në Paris! Do i paguajë Becchetit edhe 20 mijë euro shtesë

Radio Evropa e Lirë e kishte vizituar familjen e Idriz Rrecajt në Skenderaj në gusht, pasi autoritetet thanë se mbetjet mortore të zbuluara në këto varreza masive mund t'i përkisnin grupit ku bënte pjesë edhe ai.

Flora Rrecaj, bija e tij, i tha Radios Evropa e Lirë më 30 gusht se ajo dhe familjarët e tjerë e kishin kërkuar për plot 27 vjet atë nëpër lista të burgjeve në Serbi, dëshmi, informata të pakonfirmuara dhe vende ku herë pas here zbuloheshin mbetje mortore.

Në pritje të rezultateve të ADN-së për të kuptuar nëse mbetjet mortore ishin të babait të saj, ajo kishte thënë se po përjetonte ndjenja “të përziera”.

“Janë ndjenjat e dhimbjes, ndjenjat e shpresës, por janë edhe ndjenjat e frikës. Pas kaq shumë vitesh, tash e ke një frikë prej përgjigjes. Por, megjithatë, është e domosdoshme dhe shumë e nevojshme të dihet e vërteta”, kishte thënë ajo.

Ndërkohë, ende nuk dihet se kush janë dy viktimat e tjera të identifikuara.

Njoftimi i Kurtit të shtunën për identifikimin e tri viktimave vjen gati dy muaj pasi u zbuluan tri varre masive në Zubin Potok, ku u gjetën mbetje mortore të së paku 23 njerëzve.

Në fund të muajit të kaluar, autoritetet kosovare i dërguan në Hagë të Holandës mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Kurti tha se Kosova pret t'i pranojë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së “në ditët dhe javët në vijim”.

Varrezat në Zubin Potok u zbuluan rreth dy muaj më parë pas një hetimi dyvjeçar lidhur me dyshimet për krime lufte, sipas autoriteteve kosovare.

Prokuroria Speciale e Kosovës po i heton për këtë rast katër persona, J.R., M.J., R.K dhe M.B., të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile. Që të katër ndodhen në paraburgim.

Sipas Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, 1.577 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-1999, ndërsa janë dokumentuar gjithsej 12.230 viktima të luftës.

Kosova ka kërkuar vazhdimisht nga Serbia bashkëpunim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe qasje në arkivat ushtarake që sipas autoriteteve mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme./REL

policia idriz rrecaj zubin potok

Sondazh

Poll

AKTUALITET 20 SHTATOR 2025, 10:47

Vrasja në Sarandë/ Nëna sheh të birin e pajetë dhe shpërthen në lot: O djali i nënës (VIDEO)

më të klikuarat

FOTO/ Kush është Artan Myrtaj që u çekzekutua ditën e sotme, viktimja njihej si 'Tani Ruzhdiut'



VIDEO/ Banorët e Divjakës nuk tërhiqen, 51 ditë protestë kundër hartës territoriale: Jo shkrirjes së Bashkisë

DETAJET/ Si u vra Artan Myrtaj në Sarandë, u qëllua nga dy persona me motor

Trump kthehet në Shtëpinë e Bardhë, SHBA paralajmëron qytetarët për rrezikun në Lindjen e Mesme

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Aksident rrugor në aksin nacional Maqellarë– Peshkopi, plagosen nënë e bir

Foto ilustruese DIBRA- Një aksident rrugor ka ndodhur pak minuta më parë në aksin nacional Maqellarë–Peshkopi. Si pasojë&…

VIDEO/ Përfshihet nga flakët një
automjet në Gjirokaštër, policia nis
hetimin

Aktualitet
29 Shtator 2026, 16:44

VIDEO/ Bie zjarr në vendgrumbullimin e
mbeturinave në Fushë-Krujë, tymi
përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit

Aktualitet
29 Shtator 2026, 16:22

EMRI/ Ishte duke peshkuar në lumin
Setë në Dibër, humb jetën 31-vjeçari

Aktualitet
29 Shtator 2026, 16:17

VIDEO/ Zjarr pranë fshatit 'Arshi Lengo'
në Gjirokaštër, flakët u afrohen banesave

Aktualitet
29 Shtator 2026, 16:11

Atentati mafioz në Sarandë/ Komisariati ndodhet 70
metra larg vendngjarjes, policisë iu deshën 10 minuta
për të mbërritur

Dita e 113-të e protestës/ Aktorja Eglja Ceno: Kush është shqiptar e di vet ku duhet të jetë!

Aktualitet

20 Shtator 2026, 15:32

VIDEO/ Zjarr i përmasave të mëdha në Babicë të Vlorës, digjen dhjetëra ullinj shekullorë

Aktualitet

20 Shtator 2026, 15:17

E rëndë në Dibër/ Mbytet një 22-vjeçare në lumin Drini i Zi

Aktualitet


20 Shtator 2026, 15:12

"Ju erdhi fundi"/ Sot dita e 113-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

Aktualitet

20 Shtator 2026, 15:07

MË SHUMË



Bie zjarr në vendgrumbullimin e mbeturinave në Fushë-Krujë, tymi përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit



Bie zjarr në vendgrumbullimin e mbeturinave në Fushë-Krujë, tymi përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit



Zjarr pranë fshatit 'Arshi Lengo' në Gjirokastrë, flakët u afrohen banesave



Zjarr i përmasave të mëdha në Babicë të Vlorës, digjen dhjetëra ullinj shekullorë



Falsifikim dokumentash dhe përfitim i paligjshëm i pronave, arrestohet ish-drejtori i Kadastrës Fier

Bie zjarr në vendgrumbullimin e mbeturinave në Fushë-Krujë, tymi përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit



Shiko video te tjera

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MUNDËSHKAR NGA  Mediodesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.